

Këshilla përpara koncertit

Të dashur familjarë,

Meqë momenti i koncertit është afër, këtu janë disa këshilla të vogla por të rëndësishme për t'i bërë këto çaste të mrekullueshme dhe më të paharrueshme:

Mbështetja e Përbashkët:

Mundohuni të jenë sa më mbështetës ditët përpara koncertit dhe inkuarajoeni fëmijën tuaj të bëjë disa shfaqje familjare përpara jush për t'u përgatitur më mirë.

Nervozizmi:

Nëse shihni pak nervozizëm tek fëmija juaj, ofrojeni mbështetje dhe një mundësi që të shkarkojë. Nervozizmi është i zakonishëm përpara performancës, por mbështetja juaj do t'i ndihmojë të relaksohen.

Bukuritë e Gabimeve:

Gabimet janë pjesë e çdo performancë artistike, kështu që jini gati për të përkrahur fëmijën tuaj edhe në momente të vogla tensioni. Fitoja e punës së tyre nis që në momentin kur dëgjojnë emrin t'i thërritet në skenë. Ju kujtojmë që dita e koncertit është plot me emocione.

Krahasimet

Ju lutem, është shumë e rëndësishme që të mos krahasoni performancat me njëra tjetrën. Çdo nxënës ka patur rrugëtimin e tij dhe individualiteti i tyre i bën aq të ndryshëm.

Fotografitë dhe Videot:

Mos harroni të bëni disa fotografi dhe video për të kapur këtë moment të veçantë. Këto kujtime do të jenë të çmuara për ju dhe fëmijën tuaj në të ardhmen. Publiku i koncertit është me Prindër si ju dhe për të shijuar më shumë koncertin, do t'ju sugjeronim që t'i kërkonit një prindi të xhironte gjatë kohës kur luan fëmija juaj kështu ju mund të jeni të qetë të shihni koncertin.

Dhe mos harroni një foto me mësuesin/en tuaj për të kujtuar këtë moment.

Detajet e fundit:

Bëni një listë me gjërat/sendet që ju duhen për koncert, që të keni çdo gjë më vehte. Kjo do t'ju bëjë të jenë më të qetë. Përgatisni dhe veshjet për koncert dhe sigurohuni që të jenë veshje të përshtatshme por mbi të gjithë të rehatshme për fëmijën tuaj.

Një pasdite speciale:

Pavarësisht se si shkon koncerti, dita e koncertit ka nevojë të jetë një festë në familjet tuaj dhe shpresojmë të jetë kështu. Çdo përpjekje është një fitore, dhe meriton të festohet. Shfrytëzoni kohën pas koncertit për të folur mbi emocionet dhe ndjesitë e përbashkëta.